

FITOR OLLOMANI

**SHNDËRRIMET KUPTIMORE NË METAFORAT FOLJORE NË
POEZINË E ALI PODRIMES: VËLLIMI POETIK *LUM LUMI***

Gjuha si një dukuri sociale është në zhvillim të vazhdueshëm si në aspektin formal ashtu edhe në atë semantik. Zhvillimi gjuhësor duhet parë në dikotominë individ (shoqëri) – kohë, pasi individ është bartës i formës dhe kuptimit gjuhësor, pavarësisht ndryshimit, në kohë, ku për individin në sinkroni kjo formë mbetet e pandryshueshme¹ edhe pse në realitet ajo ndryshon në vazhdimësi. Në rrjedhën e kohës shoqëritë njerëzore kanë krijuar mekanizma të zhvillimit të gjuhës gjithnjë në varësi të nevojave nominuese të realitetit që i rrethonte. Në zhvillimin e gjuhës raporti formë – përmbajtje është determinues, por jo gjithnjë ky raport shkon në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në shumë raste forma bëhet bartëse e përmbajtjes së re si mbishtresëzim pergamenor. Mekanizmat e zhvillimit gjuhësor janë të ndryshëm dhe të shumtë. Sipas Aristotelit, një ndër mekanizmat më të vjetër dhe më produktiv të zhvillimit të gjuhës është mekanizmi metaforik.

Metafora është ndër mjetet më të rëndësishme në realizimin e kuptimeve të figurshme nga një përdorim të figurshëm dhe më tej.

Ajo është një proces i bartjes, translacionit kuptimor, ku emri i një sendi kalon si emërtim tek një send tjetër sipas një tipari të përbashkët, zakonisht të jashtëm, si forma, ngjyra që i lidh këto dy sende. Metafora është një zgjerim kuptimi, sepse aftësia e shënjesit rritet, nën të përfshihet si i shënjuari edhe një send tjetër, pra vëllimi i kuptimit rritet.

Sipas Jani Thomait në këtë proces krijohen boshtet kryesore kuptimore si: i parëm – i prejardhur; konkret – abstrakt, i drejtpërdrejtë – i figurshëm.²

Përmes kalimit në fazat e metaforizimit kuptimet figurative shndërrohen në kuptime gjuhësore, por si fillesë e shndërrimeve janë përdorimet stilistike të leksemave në ligjërimin letrar. Në fillim emërtimi i sendit të parë, që i vihet edhe sendit të dytë, i lidh ngushtë të dy sendet, të cilët, me të përmendur emërtimin na vijnë ndërmend të dy.

Në këtë rast kemi një figurë të mirëfilltë letrare, me tej përfytyrimi i dy sendeve shkëputet, largohen dhe përmendja e njërit nuk na sjell domosdo

¹ Andre Martine, *Elementet e gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 146

²Jani Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (Semantike leksikore)*, EDFFA, Tiranë, 2009, f. 142.

tjetrin. Atëherë emërtimi kthehet në figurë gjuhësore, për të dy sendet nuk ka emërtim tjetër, lind kështu një kuptim i ri gjuhësor.

Teoricienët e konsiderojnë metaforën si bartje kuptimi, si zëvendësim kuptimi të një fjale me kuptimin e ndonjë fjale tjetër, gëgjësisht si mënyrë të veçantë përshkrimi, që barazon një gjë me një gjë tjetër. Metafora bën të mundur të kemi ndërlidhje të një dukurie me një dukuri tjetër që në ligjërimin neutral nuk mund të ndodhë, lidhja e këtyre dukurive realizohet përmes një konteksti të veçantë.³

Pra, konteksti është vendimtar në mbartjen kuptimore të metaforës, bartja kuptimore nuk është e përcaktuar në asnjë mënyrë dhe as e kushtëzuar nga ndonjë cilësi të dukurive ndërlidhëse.

Në anën tjetër bartja kuptimore sipas përkufizimit të Jani Thomait është e kushtëzuar nga afritë midis fjalëve që emërtojnë sende me afri ngjyre, forme, madhësie, ashpërsie apo edhe të elementeve të tjera që mund të jenë të jashtme. Gjithsesi, të dy përkufizimet kanë një pikë të përbashkët atë zhvillimit të strukturës kuptimore të fjalëve që lidhen mes tyre në strukturën e metaforës duke shkuar drejt kristalizimit të kuptimeve të reja. Për këtë arsye, apo edhe për arsye të tjera që kanë të bëjnë me dukurinë e polisemantizmit John Lynos metaforën e shikon si parim i polisemantizmit në strukturën semantike të një fjale. “Në përpjekje për të provuar prejardhjen natyrore të gjuhës, grekët ngritën një radhë parimesh, të cilat shpjegonin zgjerimin e rrethit të kuptimit të një fjale mbi kuptimin e saj të vërtetë ose burimor. Më i rëndësishëm në këto parime është *metafora*, e cila mbështetet në lidhjen natyrore midis referentit parësor dhe dytësor ku përdoret fjala.

Në secilin rast dallohej një ngjashmëri formale ose funksionale midis referentëve”⁴

Në varësi të natyrës së leksemës që krijon procesin metaforik kemi klasifikimin e metaforave në metafora emra, mbiemra dhe folje. Metaforat mbiemra shpeshherë janë emërtuar edhe si epitete metaforike. Marrëdhënia mes pjesëve përbërëse të sintagmave metaforike ka bërë që të kemi një klasifikim më të gjerë të metaforave nisur edhe nga natyra e lidhjeve dhe kemi: metafora absolute⁵, imituese (Burlesque metaphor)⁶, katakrezë⁷, konceptuale, komplekse⁸, e vazhdimësisë⁹ dhe komunikimi¹⁰, metafora

³Milivoj Solar, *Hyrje në shkencën për letërsi*, SHBLU, Tiranë 2003, f. 63

⁴ John Lynos, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, DITURIA, Tiranë, 2001, f. 376.

⁵ R. S. Furness, *Expressionism*, Routledge, 1973

⁶ John Addington Symonds, *Renaissance in Italy, 1875*

⁷ J. David Sapir. *The anatomy of metaphor* in “The social Use of Metaphor”, edited by J. David Sapir and J. C Crocker, University of Pennsylvania Press, 1977

⁸ Zoltan Kovecses, *Metaphor in Culture Universality and Variation*, Cambridge University, Press, 2005

konvencionale¹¹, metafora stilistikore (kreative)¹² dhe metafora e vdekur (ngurtësuar)¹³.

Në tërë morinë e metaforave të sipërpërmendura, në punimin tonë interes të veçantë paraqet metafora konceptuale.

Baza e metaforës konceptuale është pjesë e zakonshme e aparatit konceptual të shpërndarë nga kujtesa kulturore. Metaforat konceptuale janë krijuar në raportin e lidhjeve mes strukturës konceptuale të sferës së njohjes dhe termave (fjalëve) emërtuese të kësaj pjese të kulturës. Metaforat konceptuale i kuptojmë vetëm në aspektin e përvojave të përbashkëta. Metaforat konceptuale janë të thjeshta (nuk përfshijnë pjesën e vetëdijes), edhe pse mund të tërheqin vëmendjen tonë. Operacioni i njohjes mbi to është pothuaj automatik. Metaforat konceptuale janë konvencionalizuar (shënjuar), gjerësisht në gjuhë; madje ekzistojnë një numër i madh fjalësh, kuptimi i të cilave është në varësi të metaforave konceptuale. Kjo është mënyra përmes së cilës janë krijuar dhe ekzistojnë metaforat e tilla. Thënë ndryshe, kuptimi metaforik i këtyre fjalëve është bërë pjesë e vetëdijes gjuhësore, vetëm në këtë mënyrë, duke i bërë të duken se ekzistojnë vetëm në këtë mënyrë. Dallimi mes metaforës konceptuale dhe metaforës komplekse ka të bëjë me lidhjet me burimin, që ekziston dhe mungon te njëra dhe tek tjetra. Në ligjërimin e përditshëm metaforat konceptuale përcjellin një koncept, i cili mund të perceptohet vetëm në këtë mënyrë dhe në asnjë mënyrë tjetër. Metaforat konceptuale shpeshherë janë ngurtësuar në fjalë të urta ose idioma në ligjërimin popullor: *shpirti nuk blihet me para, koha është flori, koha është e shenjtë, ju jeni jashtë kohe, shpenzova shumë kohë, humba shumë kohë, ju kushtova shumë kohë etj.*, këto metafora janë derivime të marrëdhënieve konceptuale në një kohë të largët, gjë që ka bërë të humbasin lidhjet me burimin prej të cilit kanë rrjedhur edhe pse kanë një gjenezë stilistike.

⁹ Michael J. Reddy *The Conduit Metaphor* "A case of frame Conflict in Our Language about Language, "Metaphor and Thought" ed, by, Andrew Ortony, Cambridge, University Press 1979

¹⁰ Philip Eubanks, *Metaphor and Writing: Figurative Thought in the Discourse of Written Communication* Cambridge University Press 2011

¹¹ Murray Knowels and Rosamund Moon *Introducing Metaphor*, Routledge, 2006

¹² Murray Knowels and Rosamund Moon, *Introduction metaphor*, Routledge, 2006 and Carl R. Hausman, *Metaphor and art*, Cambridge University Press, 1989

¹³ Samuel Guttenplan, *Object of Metaphor*, Oxford University, Press, 2005 and Gregory W Dawes, "The Body in Question": *Metaphor and Meaning in the Interpretation of Ephesians 5:21- 33*. Brill, 1998

Teoria e metaforës konceptuale refuzon idenë se metafora është mjet dekorativ periferik në gjuhë dhe mendim pasi po të shikojmë me vëmendje në qendër të saj është veprimi i shprehur përmes foljes pavarësisht pjesëve të ligjëratës që janë përbërëse të fjalive metaforike.

Kuptimi i një sfare përmes termave, na çon drejt një sfare tjetër të fiksuar në lidhjet mes origjinës (i quajtur teknikisht hartë, planifikim semantik) dhe sferës së synuar më parë. Kjo strukturë e planifikimit (semantik) ekziston mes elementeve përbërëse të sferës së synuar. Për të njohur metaforën konceptuale duhet të njihet struktura e planifikimit semantik që është zbatuar për të dhënë dysinë burim – synim (burimi i synuar në aspektin semantik). Këto janë planifikime semantike që japin shumë kuptime të metaforës gjuhësore të shprehjes, ose thjesht të metaforës gjuhësore që krijojnë shfaqje të veçanta të metaforës konceptuale. Poezia është forma ligjërimore ku metafora konceptuale merr jetë.

Për të jetësuar modelin e metaforizimit të këtij lloji metaforik i referohemi poezisë së Podrimes.

Poezia e Ali Podrimes të krijon mundësinë të lundrosh në detin semantik të tropeve gjuhësore në përgjithësi dhe të metaforës në veçanti. Ajo është e pasur me llojshmëri metaforash, ku marrëdhënia semantike mes leksemave është një tendencë e pasurimit semantik të gjuhës shqipe.

Poezia e Podrimes është një shpërthim i zjarrtë i ndjenjave kryetipore, që shtresohen dhe sublimohen përmes figurave: metaforë, simbol, antitezë etj., edhe gjuha poetike rrezaton lirizmin e kulluar, imazhin e jetës shqiptare që shpjegohet përmes dhembjes¹⁴

Pra siç shihet, metafora zë vendin kryesor në opusin e figurave stilistike të shprehisë poetike; ndaj hulumtimi i mekanizmit metaforik në metaforat foljore është një hetim mbi larminë dhe mundësinë e pasurimit semantik dhe formal të formave gjuhësore të shqipes. Podrimja ka sjellë një risi në lidhje me shprehjen dhe gjuhën¹⁵ do të shprehej Rexhep Ismajli.

Poezia e tij ka krijuar sisteme metaforike, në jetësimin e raportit metonimik atdhe – etni, autori a krijuar sistemet kryesore metaforiko – simbolike¹⁶, ku vetëm përmes simboleve të tilla mund të përjetësohen raporte të tilla.

Metafora ka qenë mjet i fuqishëm për të krijuar botën konceptuale poetike të mohuar në të vërtetë, atë që i mungoi Podrimes, vendlindjen etnike.

¹⁴ Sali Bashota, *Jetëshkrim i dhembjes njerëzore* (2003) parathënie e vëllimit poetik “Lum Lumi” i Ali Podrimes, Koha, Prishtinë, 2012, f. 12.

¹⁵ Rexhep Ismajli, *Poeti Podrimja* (2012), pjesë e parathënies e vëllimit poetik, “Lum Lumi” i Ali Podrimes, Koha, Prishtinë, 2012, f. 14.

¹⁶ Bashkim Kuçuku, *Shprehja moderne e etnisë*, parathënie e vëllimit poetik “Litar i ankthit” (Poezi të zgjedhura) të Ali Podrimes, Toena, Tiranë, 2002, f. 6.

Atë ai e krijoi përmes metaforës. Ai konceptualizoi dhimbjen, dashurinë, durimin duke i vendosur në kohë dhe në hapësirë pa shprishur rrjedhën e universalizmit hapësinor të tyre, madje metafora i shërbeu për të kapërcyer hapësira në përballimin e dhimbjes, në shprehjen e dashurisë duke bërë përgjithësime konceptuale të këtyre ndjesive.

Metafora u bë mjet i rëndësishëm në parashtrimin e realitetit që duhet të mungojë dhe të jetë i pranishëm në të njëjtën kohë në eliptizmin e Podrimes.

Ai solli, përmes mungesës, rrethanat, faktorët dhe shtigjet e kërkimit të vetvetes në trajtëformën metaforike.

Metafora në poezinë e Podrimes nuk mund të kuptohet parë e shkëputur nga figura të tjera stilistike dhe gjuhësore aq më tepër kur bëhet fjalë për figurën e elipsës, kjo e bën që ajo të jetë “poezi e thukët” (koncize) jo vetëm se është metaforike, por se është edhe eliptike, mungesore.

Në të gjithmonë mungon diçka: emra, folje, ndajfolje, përemra të llojeve të ndryshme, lidhëza, pjesëza para fjala madje duke përfunduar edhe në rrokje.¹⁷

Prania e mungesës (elipsës) bën që marrëdhënia mes pjesëve të sintagmës metaforike vizualisht, të jetë e munguar, por të jetë e pranishme semantikisht përmes plotësimit imagjnativ, ku shndërrimet kuptimore në metafora të tilla bëhet përmes pranisë së mendimit të pashkruar.

*Sorra të dergjura / grimcojnë / ëndrrën / dhe myshku emrin në gurë*¹⁸

Marrëdhënia metaforike në këtë strukturë të metaforës folje krijohet nga lidhja e foljes *grimcojnë* me sintagmën *sorrrat të dergjura* dhe emrave *ëndrrën, myshkun dhe emrin*.

Marrëdhënia krijohet nga kalimi nga gjendje e lartë abstrakte duke zbritur në një element konkret dhe përsëri kemi një gjendje abstrakte, ku marrëdhënia mes emrit të myshkut dhe emrit bëhet edhe më abstrakte duke patur parasysh natyrën e veprimit dhe cilësitë e dy emrave që janë plotës valencor të veprimit (myshku si i përkohshëm dhe emri si një dukuri jo shumë e qëndrueshme në rrethana të tilla). Mungesa e lidhëzës shtuese *dhe* këtë marrëdhënie e bën akoma më abstrakte për vetë faktin se procesi nuk vjen përmes shtimit por si një unikalitet dhe individualitet i papërsëritshëm. Kështu kuptimi i foljes *grimcoj* (*grimcojnë*) kalon në stadin figurativ dhe më pas në një kuptim gjuhësisht të pranuar, ku kemi *grimcoj* ndaj në thërrmija të vogla, por tashmë një emër të shkruar në myshkun e gurit, një ëndërr, pra një ideal. Folja paraqitet me mundësi të mëdha lidhjeje me pjesë të ndryshme të fjalisë, ku lidhja më e qenësishme në aspektin metaforik është me sintagmën kryefjalore (*sorrrat e dergjura*) dhe me emrin kundrinë (ëndrrën, myshku).

¹⁷ Po aty, f. 21.

¹⁸ Ali Podrimja, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 24.

Metaforat foljore krijojnë mundësinë e shprehjes së veprimit të brendshëm të unit lirik, të mendimit në rrjedhë të pandalshme.

Krijimi i metaforave folje është në përputhje me tërë strukturën sintaksore të gjuhës përkatëse, ndaj në metaforat të tilla nuk duhet kërkuar shndërrimi kuptimor vetëm si produkt i marrëdhënieve semantike mes pjesëve përbërëse, por si shumë e kuptimeve leksikore, sintaksore dhe morfologjike.

*E ai det / ëndrrën ma vjedh /..... kurse unë e gjuaj me vjet. Në rrethe mbyll në fjalë / mure rrënon hapësirë pushton. Në majë të klithjes sime kacavaret*¹⁹

Në strukturën e metaforës folje prania e njëres gjymtyrë ose mungesa e saj është shumë e rëndësishme pasi marrëdhënia mes tyre vjen e aktualizuar përmes semave potenciale që mbartin. Le të shohim strukturën e metaforave të sipërpërmendura:

E ai det ëndrrën ma vjedh. Dukuria e vjedhjes vjen në trajtën e përhumbjes, por kjo vetëm në prani të leksemës *det* e aq më tepër autori e individualizon përmes përemrit vetor. Mungesa e leksemës *det* do të sillte një shprehje të ekuilibrave perceptues të dukurisë dhe për më tepër do të sillte një stuhi pështjelluese të mendimeve për vepruesin.

Metafora tjetër, *kurse unë e gjuaj me vjet* në raporte kundërshtie dhe marrëdhënie varësie me metaforën pararendëse të krijon idenë e një kundërpërgjigjeje, por edhe kjo metaforë është e ndërtuar mbi baza sintaksore të plota të shqipes, ku folja paraqitet me dy valenca në lidhje me kundrinën dhe kryefjalën. Marrëdhënia semantike mes pjesëve përbërëse është akoma në stadin figurativ duke mos kaluar në fazën e figurës gjuhësore.

Vëllimi poetik “Lum Lumi” mbetet një përmbledhje poetike e dhimbjes njerëzore, e marrëdhënies mes mbijetesës dhe vdekjes së parakohshme që pret fillet e një jete të panisur akoma. Veprimi i brendshëm poetik është në shkallën më të lartë duke bërë që marrëdhënia formë gjuhësore dhe mendim të mbetet e paperceptueshme në nivelin gjuhësor, por vetëm përmes aktualizimit të semave më potente të shprehjes gjithnjë në funksion të shprehjes së dhimbjes së pakufishme të babait për humbjen e djalit, një humbje që merr trajtën metaforike të drejtimit, betejës, qytetit e aq më tepër uni lirik humbi kohën e cunguar dhe të përçudnuar.

*U nisa drejt Diellit ora binte dymbëdhjetë /...../ Pastaj rëra zu të ma mbulojë trupin fjalët ëndrrat..... humba drejtimet betejat qytetet..... Vetëm ora e thyer mbeti dhe syri im çel*²⁰

Në shprehjen e kësaj gjendjeje rol të veçantë luajnë leksemat foljore si: *u nisa, binte, mbulojë, humba, mbeti, çeli*. Çdo folje ka të aktualizuar jo semat

¹⁹ Po aty, f. 27.

²⁰ Po aty, f. 26.

e para kuptimore, por semat ku marrëdhënia semantike është në nivelet më të larta abstragimi.

Folja **bie** – **binte** në metaforën *ora binte dymbëdhjetë* ka të aktualizuar sema nga kuptimi i 19 –të (ra, shënonte, ishte) i strukturës hierarkike, por edhe në këtë rast ka një tendencë të aktualizimit të semave jo vetëm figurative por potenciale të paaktualizuara më parë.

Në analogji me metaforën *ora binte dymbëdhjetë* do të kishim *ora shënonte dymbëdhjetë* pra shënimi i kohës realizohet përmes një foljeje me një strukturë hierarkike kuptimore shumë produktive.

Edhe pse me një strukturë kuptimore prej 44 kuptimesh, folja **bie** ka tendencë të zgjerimit kuptimor, natyrisht zgjerimi i strukturave në masë të tillë krijon një largësi nga boshti semantik primar duke krijuar boshte semantike individuale sipas parimeve të polismenatizmit. Kjo metaforë është në stadin e ndërmjetëm të konvencionalizmit gjuhësor të saj duke u shndërruar në një figurë gjuhësore duke mos mbetur figurë stilistike gjuhësore.

Në të njëjtin stad është edhe metafora *humba drejtimin betejat qytetin*, folja *humba* në këtë metaforë ka të aktualizuar semat e kuptimeve të 13 (Ngatërroj rrugën e a gaboje drejtimin, nuk di nga të vete më tej), 14 (Largohem nga rruga e nisur, detyrohem të heq dorë nga synimet, nga ëndrrat) dhe 15 (Dal i mundur në një luftë në një betejë dhe ndeshje)²¹ (Fjalori i gjuhës shqipe, 1980; 697). Marrëdhënia shtuese bashkërenditëse mes pjesëve të fjalisë duke krijuar gjymtyrë homogjene i ka dhënë mundësi foljes *humb* të aktualizojë tre kuptime në të njëjtën kohë duke krijuar një strukturë metaforike mbi baza të metaforave të vdekura si: *humba drejtimin*, *humba betejën*, *humba qytetin*, kjo e fundit në formën e një sinekdoke (vendi në vend të njerëzve), por kontekstualisht mund të kemi një metaforë e cila mbetet në nivelin e një metafore të thjeshtë.

Ndërsa metaforat *U nisa drejt Diellit*, *Pastaj rëra zu të ma mbulojë trupin fjalët ëndrrat... Vetëm ora e thyer mbeti dhe syri im çel mbesin në stadin e metaforave kreative*, pa kaluar në metafora konceptuale gjuhësore. Nga ana tjetër këto struktura paraqesin potencialin e shëndrimeve kuptimore drejt abstragimit semantik gjuhësor.

Në galerinë e metaforave të poezisë së Ali Podrimes ekzistojnë një shumësi metaforash, ku shndërrimi kuptimor ka arritur në stadin e figurave gjuhësore, në të cilat emërtimi i një dukurie nuk na kujton domosdoshmërisht dukurinë primare të emërtimit fillestar metaforik, metafora të tilla janë:

Dredha e pluhurit / *na humbi udhën* / në shkretëtirë (*Nokturno*, f. 22),
Koha e notuseve perendoj (Uji i madh, f. 25), Vetminë do e mund me fyell

²¹ *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1980, f. 697.

(*Para të panjohurës*, f. 130), *Të lëshojë pe ta zemë në kokëfortësinë e vet* (*Çështje*, f. 133)

Nuk na ndan vdekja plaku im / harrimi na ndan koha..... kur të zgjoj / lulon dhembja. (*Mbreti im i vdekur dioklecian*). Fjalën kushtrim peshonte fjalën besë (*Kullë e lartë* f. 33)

Në rrethe mbyll në fjalë / mure rrënon hapësirë pushton. (*Ai det*, f. 27)

Udhëtuam kah ylli ynë që digjej në kep / Ti mëso të ecësh me këmbët e tua/ *Pastërtia e syrit tënd më kapërdin të tërin. Fjalët na u harxhuan / na mundi udhë e frikshme* (*Deri në fund*, f. 42 – 43). Larg shumë larg Lumi / këmbët më ranë bërrylat m'u përgjakën duke të ndjekur (*Vdekja më e shpejtë se unë*, f. 95)²².

Natyrisht, gjuha e vëllimit poetik “Lum Lumi”, e përqendruar në figurativitet, fiton strukturën tjetër semantike duke u shndërruar në gjuhë mimetike²³, duke bërë që shënjimi i momenteve jetësore të marrin një trajtë universale përmes kalfifikimit të strukturës semantike figurative në një strukturë semantike gjuhësore duke e përjetësuar si pjesë e vetëdijes kolektive gjuhësore.

Opusi metaforik i Podrimes vjen e bëhet më interesant me struktura metaforike foljore që janë në stadin e figurave stilistike, pra duke mbetur në nivelin e metaforave kreative, por që kërkojnë ndihmën e metaforave komplekse për t'u përkapur semantikisht. Metafora të tilla kemi:

Mbi plagën time çel ëndrra edhe i stinë. Ma ngrin fjalën majë gjuhe / Syrin ma therr dashurin mijëvjeçare / cipërdoncullak ma zdash shpritin.

Përmes korpusit metaforik foljor krijohet imazhi i gjendjeve të unit lirik, një çelje plage, një ngrirje gjuhe, therrje dashurie dhe së fundi një zdejsh shpirti, ky imazh vjen e formësohet semantikisht në vetëdijen e dëgjuesit (lexuesit) përmes gërmimit në thellësitë e vetëdijes gjuhësore të tij.

Në krijimin e kontureve të karabinës metaforike, Podrimja është kujdesur të mos përjashtojë larmishmërinë e ligjërit popullor, pasi shprehja e përkatësisë universale të unit lirik në kohë dhe hapësirë mund të realizohet më së miri përmes këtij ligjërimi.

Kur të flasësh fol të dëgjohesh në bjeshkë, të dëgjohesh në shkretëtirë/ ta provojmë vetveten derisa kemi frymë (*Me jetue*, f. 39). *Pse Lumi gjithmonë kërkon atë që nuk mund ta gjejë kur e di Jashtë lëkure nuk mund të dal* (*Kërkon atë që nuk mund ta gjej*, f. 41)

Ti mëso të ecësh me këmbët e tua / kurrë mos pështyji në dashuri mallkimi i fisit / Urrejta është më e rëndë se vrasja. Por Ora por Ora jonë shtangu në ajër / fjalët na u harxhuan / na mundi udhë e frikshme (*Deri në*

²² Të gjitha metaforat e mësipërme janë marrë nga vëllimi poetik i Ali Podrimes, “Lum Lumi”, Koha, Prishtinë, 2012, sipas faqeve përkatëse.

²³ Ramadan Musliu, *Mbindërtimi poetik*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 149 – 150.

fund, f. 42 – 43) Koha nuk ishte as e të gjallëve (Në fund të botës, f. 68). Të mos rrëshqasë toka nën këmbë të mos humbasë qielli mbi kokë (Ekzistenca, f. 46.) U bëmë veshë u bëmë sy e tërë Familja (Zbrastësia, f. 101)

Poeti nuk mund t'i shpëtojë individualiteti, ai dhimbjen e shikon si pjesë e individuale ndaj përdorimi i përemrit pronor krijon situatën e veçimit të përjetimit të dhembjes përmes personifikimit metaforik që i bën dukurisë.

Dhembja ime ka dy sy, dy vesh një hundë ka duar këmbë ashtërore dhe një peshë / Ajo rri e më shikon çuditshëm / Ajo rri e më shikon llahtarshëm (Dhembja ime, f. 48)

Zoti s'është i zi / S'është i zi Zoti / Nga bardhësia dhoma verbohët në një guaskë. (Në dhomën e vdekjes, f. 49).

Si përfundim mund të themi se:

Metaforat foljore janë metafora ku abstraksioni semantik është në shkallën më të lartë, kjo në të dy rastet kur janë pjesë e figurave stilistike dhe kur janë pjesë e figurave gjuhësore.

Shumë metafora foljore janë metafora të vdekura, ose ekzistojnë si të tilla në vetëdijen e folësve të përjetësuar si të tilla në poezinë e Podrimes.

Në shumicën e rasteve leksemat foljore kanë të aktualizuar semat më potenciale në aspektin figurativ, ndërsa në metafora të vdekura foljet kanë struktura shumë të gjëra kuptimore.

Në poezinë e Podrimes ekzistojnë një shumësi metaforash foljore të të dy llojeve ku potenciali i shndërrimeve kuptimore është në stadet më të larta.

Në universalizimin e imazheve, veprimeve dhe humbjes së etimologjisë primare të shndërrimeve kuptimore në metaforat folje ka ndikuar përdorimi i së shkuarës përmes formës të së pakryerës së dëftores dhe të lidhores të foljeve.

Poezia e Ali Podrimes është e mbarsur me ligjërimin metaforik popullor duke krijuar mozaikun semantik të imazheve universale.

BIBLIOGRAFI:

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 1980

Aristoteli, "Poetika" Prishtinë, Rilindja, 1984.

A. Martine, *Elementet e gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, Dituria, 2002.

A. Podrimja, *Litari i ankhit (poezi te zgjedhura)*, Tiranë, Toena, 2002.

A. Podrimja, *Lum Lumi*, Prishtinë, Koha, 2012.

B. Bejta, *Gjuha dhe të folurit*, Prishtinë, Buzuku, 2007.

B. T. Stull, *The Elements of Figurative language*, Florida Atlantic University, 2001.

E. Sapir, *Gjuha – Hyrje në studimin e ligjërimin*, Prishtinë, Rilindja, 1980.

- F. Agalliu, E. Angoni, Sh. Demiraj, A. Dhrimo, E. Hysa, E. Lafe, E. Likaj, *Gramtika e gjuhës shqipe (vëllimi I)*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, SHBLU, 2002.
- G. Grafi, *Sintaksa” (strukturat e ligjërit)*, Tiranë, Dituria, 2003.
- J. David Sapir. *The anatomy of metaphor* in *The social Use of Metaphor*, edited by J. David Sapir and J. C. Crocker, University of Pennsylvania Press, 1977.
- J. Lynos, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë, Dituria, 2001.
- J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe, (semantika leksikore)*, EDFFA, 2009.
- M. Pozzato, *Semiotika e tekstit*, Tiranë, SHBLU, 2005.
- M. Solar, *Hyrje në shkencën për letërsi*, Tiranë, SHBLU, 2001.
- R. Frost, *Education by Poetry*, Amherst Garduates’ Qyarterly, Feb. 1931.
- S. Glugsberg, *Understanding figurative language* (From metafore to idioms), Oxford psychology series, OXFORD University Press, 2001.
- S. Guttenplan, *Object of Metaphor*, Oxford University, Press, 2005 and Gregory W Dawes, “The Body in Question”: *Metaphor and Meaning in the Interpretation of Ephesians 5:21- 33*. Brill, 1998.
- Sh. Islamaj, *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, Prishtinë, Rilindja, 2004.
- Sh. Bali, *Gjuha dhe jeta*, Tiranë, 2006 .
- Z. Kovecses, *Metaphor in Culture, Universality and Variation*, Cambridge University, Press 2005.